# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

www.legjislacionishqiptar.gov.al

**Nr.62** **2006**

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---|---|---|
| Dekret nr.4916 datë 9.6.2006 | Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare……………………………. | 1719 |
| Urdhër i MF nr.20, datë 13.6.2006 | Për disa ndryshime në urdhrin nr.9, datë 10.03.2005 të Ministrit të Financave "Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit "Taibah International", e njohur dhe si shoqata ndërkombëtare e ndihmave, i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit"………………………………………. | 1720 |
| Urdhër i MF nr.21, datë 13.6.2006 | Për disa ndryshime në urdhrin nr.10, datë 10.03.2005 të Ministrit të Financave "Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit "Al Haramania", i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit"……………………………… | 1720 |
| Urdhër i MF nr.22, datë 13.6.2006 | Për një ndryshim në urdhrin nr.6, datë 25.11.2005 "Për sekuestrimin e aseteve të shtetasit jordanez Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si: a) Abdyl Latif A.A. Saleh, b) Abdyl Latif Saleh, c) dr.Abd Al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A. Saleh Abu Hussein, e) Abd Al-Latif Salih, f) Abu Amir"…………………………………………………………………. | 1721 |
| | Shpallje kërkese për shpronësim për interes publik për ndërtimin e kanalit të ujërave të bardha gjatë segmentit rrugor Tre Urat, Çarshovë…………………………………………………. | 1722 |
| | Shpallje kërkese për shpronësim për interes publik për ndërtimin e infrastrukturës portuale në portin e Durrësit…….. | 1722 |
| | Shpallje kërkese për shpronësim për interes publik për | |

ndërtimin e kanalit të QPU Livadhe, 1723 Shkodër…………………..

**DEKRET**
**Nr.4916, datë 9.6.2006**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1.Rudina Tajfun Hasanbelli
2.Doreed Hani Hasanbelli
3.Raimonda Agron Harka
4.Daniela Vehbi Spahiu
5.Ergyst Kadri Kulla
6.Klodiana Sherif Hida
7.Metius Ndriçim Hyska
8.Suzana Demir Pepi (Bylyku)
9.Eliane Vladimir Pepi
10.Savina Vladimir Pepi
11.Meliha Bashkim Zari
12.Someo Sokol Selmanaj
13.Klaudia Sokol Selmanaj
14.Genti Kasëm Plaka
15.Marlon Hasan Kazazi
16.Genci Krenar Halimi
17.Sonila Budin Ottink (Gjini)
18.Daniel Meik Ottink
19.Jonas Meik Ottink
20.Elona Pëllumb Kallashi
21.Bashkim Kadri Kodra
22.Agron Xhemal Kaca
23.Esa Skënder Qeleshi
24.Edlir Zenel Veizaj
25.Senada Hajdar Keçi (Mehmetaj)
26.Arta Pjetër Ramaj
27.Tanush Syrja Frashëri
28.Alife Safa Frashëri (Vlora)
29.Genti Sotir Gjonçe
30.Aleks Hajdin Rushiti
31.Hilda Esat Radheshi (Hyka)
32.Bernard Muharrem Kikaj
33.Gentiana Vladimir Qorri (Bano)
34.Esmeralda Idriz Zekaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Alfred Moisiu**

**URDHËR**
**Nr.20, datë 13.6.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 9, DATË 10.03.2005 TË MINISTRIT TË**

**FINANCAVE "PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT "TAIBAH INTERNATIONAL", E NJOHUR DHE SI SHOQATA NDËRKOMBËTARE E NDIHMAVE, I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjit nr. 9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit" i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.9, datë 10.03.2005 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në fjalinë e parë të pikës 9 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Shprehja "për transaksionet", zëvendësohet nga shprehja "mbi evidentimin e pasurive sipas pikave 3, 4, 5 dhe 6 të këtij urdhri dhe transaksionet".

2. Fjalia e dytë e pikës 9 ndryshon si më poshtë:

"RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave brenda 72 orëve nga momenti i konstatimit të transaksioneve ose ekzistencës së këtyre pasurive të përcaktuara në pikat 3, 4, 5 dhe 6 të këtij urdhri".

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

"Brenda 3 ditëve të njoftohen me shkrim për llogaritë bankare, pasuritë, investimet, aktivitetet e tjera, si dhe vendndodhjen e tyre, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave".

4. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr. 9258, datë 15.07.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave" i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

5. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
**Ridvan Bode**

**URDHËR**
**Nr.21, datë 13.6.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 10, DATË 10.03.2005 TË MINISTRIT TË FINANCAVE "PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT "AL HARAMANIA", I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjit nr.9258 date 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit" i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhërin nr.10, datë 10.03.2005 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1.Në fjalinë e parë të pikës 9 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Shprehja "për transaksionet", zëvendësohet nga shprehja "Mbi evidentimin e pasurive sipas pikave 4, 5 dhe 6 të këtij urdhri dhe transaksionet".

2. Fjalia e dytë e pikës 9 ndryshon si më poshtë:

"RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave brenda 72 orëve nga momenti i konstatimit të transaksioneve ose ekzistencës së këtyre pasurive të përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 6 të këtij urdhri".

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

"Brenda 3 ditëve, të njoftohen me shkrim për llogaritë bankare, pasuritë, investimet, aktivitetet e tjera, si dhe vendndodhjen e tyre, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave".

4. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.07.2004 subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave" i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

5. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
**Ridvan Bode**

## URDHËR
## Nr.22, datë 13.6.2006

## PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 6, DATË 25.11.2005 "PËR SEKUESTRIMIN E ASETEVE TË SHTETASIT JORDANEZ ABDUL LATIF SALEH, I NJOHUR EDHE SI: A) ABDYL LATIF A.A. SALEH, B) ABDYL LATIF SALEH, C) DR. ABD AL-LATIF SALEH, D) ABDYL LATIF A.A. SALEH ABU HUSSEIN, E) ABD AL-LATIF SALIH, F) ABU AMIR"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjit nr. 9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit" i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.6, datë 25.11.2005 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

"Të plotësohet raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD) për evidentimin e pasurive sipas këtij urdhri dhe transaksionet që transferojnë pronësinë e llogarive, investimeve ose të pasurive të tjera të mbajtura nga subjekti duke filluar nga data 16.09.2005. RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave brenda 72 orëve nga momenti i konstatimit të transaksioneve ose ekzistencës së këtyre pasurive të përcaktuara në këtë urdhër".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave" i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
**Ridvan Bode**

## SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit "Për ndërtimin e kanalit të ujërave të bardha gjatë segmentit rrugor Tre Urat, Çarshovë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarin sipas listës emërore të mëposhtme.

PRONARI QË DO TË SHPRONËSOHET NGA NDËRTIMI I KANALIT TË UJËRAVE TË BARDHA GJATË SEGMENTIT RRUGOR TRE URAT ÇARSHOVË

| Nr. | Emri | Pasuria | Zona kadastrale | Sipërfaqja | Çmimi në lekë për $m^2$ | Vlera në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Jani Sotir Xhallo | Nr.163/26 | 1356 | 373 $m^2$ | 700 | 261 100 |

Vlera totale e këtij shpronësim është 261 100 (dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind) lekë.

**SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit "Për ndërtimin e infrastrukturës portuale në portin e Durrësit".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Portual Durrës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për secilin person sipas listës emërore të mëposhtme.

PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS PORTUALE NË PORTIN E DURRËSIT

| Nr. | Emri | Pasuria | Zona kadastrale | Sipërfaqja | Çmimi në lekë për $m^2$ | Vlera në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | **Bashkëpronarët** | nr.7/51 | 8514 | 3.703 $m^2$ | 3000 | 11.109.000 |
| | Krisanthi Qirko | 7/52 | | | | |
| | Spiro Qirko | | | | | |
| | Margarita Qirko | | | | | |
| | Mukades Kapshtica | | | | | |
| | Sanie Kapshtica | | | | | |
| | Viktoria Kraja | | | | | |
| | Nadia Kapshtica | | | | | |
| | Ana Veizi | | | | | |
| 2. | **Bashkëpronarët** | nr.6/108 | 8514 | 3.600 $m^2$ | 3000 | 10.800.000 |
| | Rudolf Lara | | | | | |
| | Kozma Lara | | | | | |
| | Vangjel Lara | | | | | |
| | Veronika Lara | | | | | |
| | Sotireta Lara | | | | | |
| | Dhimitër Lara | | | | | |
| 3. | **Bashkëpronarët** | Nr.7/48 | 8514 | 3.315 $m^2$ | 3000 | 9.945.000 |
| | Hava Stërmilli | | | | | |
| | Burhan Stërmilli | | | | | |
| | Idajet Stërmilli | | | | | |
| | Djana Stërmillli | | | | | |
| | Engjëllushe Stërmilli | | | | | |
| | Sitki Stërmilli | | | | | |
| | Lemi Stërmilli | | | | | |

Vlera totale e këtij shpronësimi është 31 854 000 (tridhjetë e një milion e tetëqind e pesëdhjetë

e katër mijë) lekë.

**SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit “Për ndërtimin e kanalit të QPU Livadhe, Shkodër.

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Shkodër. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për secilin person sipas listës emërore të mëposhtme.

PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I KANALIT TË UJËRAVE TË BARDHA TË QPU LIVADHE SHKODËR

| Nr. | Emri | Pasuria | Zona kadastrale | Sipërfaqja | Çmimi në lekë për $m^2$ | Vlera në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | **Bashkëpronarët** | | | | | |
| | Ferid Hamid Llluja | Nr.8/707 | 8591 | 2000 $m^2$ | 4500 | 9.000 000 |
| | Ferdi Hamid Llluja | | | | | |
| | Lavdije Hamid Llluja | | | | | |
| | Fitnete Hamit Llluja | | | | | |

Vlera totale e këtij shpronësimi është 9 000 000 (nëntë milionë) lekë.

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare**
**ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”,
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. **PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)……………………………………… 1500**
2. **PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) ………………………………………… 600**
3. **PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006) 1500**
4. **PËR TAKSAT DHE TATIMET…(+ suplement 2006)………………… 1500**

1. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT……………………… 1500**
2. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT…………………………………… 2000**

## Botime të reja

1. **PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT……….. 500**
2. **KODI DOGANOR…………………………………………………………………... 1000**
3. **KODI DETAR ……………………………………………………………………… 1000**

Hyri në shtyp më 16.6.2006
Doli nga shtypi më 17.6.2006

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 4000 copë | Formati: 60x88/8 |

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë